



Ne kuader te permiresimit te vazhdueshem te sistemit te menaxhimit, DPA ka rishikuar se fundi disa nga politikat e saj. Ndryshimet me te rendesishme kane ndodhur ne politikat DA-PO-005, DA-PO-007 dhe DA-PO-008.

Politika DA-PO-005

Dokumenti DA-PO-005 pershkruan politiken e DPA në lidhje me kushtet dhe rregullat për përdorimin e logos së DPA-së, simbolit të akreditimit, mbrojtjen e simboleve të akreditimit nga keqpërdorimi, rregullon përdorimin e kombinuar të logos së ILAC MRA dhe IAF MLA së bashku me simbolet e akreditimit dhe referencën për akreditim dhe statusin EA-MLA të DPA-së. Ndryshimet kryesore jane:

1. Organet e vlerësimit të konformitetit të akredituara nga DPA janë të detyruar të përdorin simbolin e akreditimit ose referencën si tekst për akreditim në raporte / çertifikata në mënyrë që të provojnë njohjen e kompetencës së tyre tek një palë e tretë, ose kur raportet / certifikatat që përmbajnë rezultate të mbuluara nga fusha e akreditimit janë në zonën ku akreditimi është i detyrueshëm me ligj ose në kushtet e kontratës. Kur simboli i akreditimit ose referenca si tekst për akreditimin nuk përdoret në një raport / certifikatë, përputhshmëria me standardin përkatës të akreditimit nuk prezumohet dhe aktiviteti nuk do të njihet si një aktivitet i akredituar, rrjedhimisht nuk mbulohet nga MLA.
2. Laboratorët testues dhe mjekësorë të akredituar nga DPA janë të detyruar të përdorin simbolin e akreditimit ose referencën në akreditim si tekst në të gjitha raportet/certifikatat në të cilat të paktën një test është i akredituar. Testet e akredituara do të shënohen me yll (*). Në fund të raportit të testimit do të jetë gjithmonë shënimi: Yll (*) tregon qe testi eshte i akredituar.
3. OVK e akredituar mund të bëjë referencë tek akreditimi si tekst sipas formulimit: "OVK-ja e akredituar nga DPA sipas numrit të akreditimit XX XXX XX.XX.XX> për aktivitetin:" ku aktiviteti mund të jetë: testim, ekzaminim mjekësor, kalibrim, inspektim, certifikim të produkteve, certifikim të sistemeve të menaxhimit, certifikim të personave.
4. Një organ i akredituar nga DPA nuk duhet të ofrojë certifikim sipas asnjë standardi të përdorur si bazë për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit (p.sh. ISO / IEC 17025, ISO 151989). DPA-së i kërkohet të fillojë procedurën e pezullimin të akreditimit të këtij organi i cili siguron çertifikime të tilla.
5. Një OVK e akredituar nga DPA nuk mund t'i referohet standardit të akreditimit në certifikatat e akredituara të lëshuara prej tij. Një çertifikim i akredituar lëshohet vetëm kundrejt dokumenteve / standardeve që përmbajnë kërkesat e skemës së certifikimit.
6. Tek simboli i akreditimit, në rastin e laboratorëve mjekësorë do të përdoret shkurtimit "LM" për te treguar llojin e organit të vleresimit te konformitetit
7. DPA është nënshkruese e marrëveshjeve shumëpalëshe të Bashkëpunimit Evropian për Akreditimin (EA) për testimin (ISO / IEC 17025), inspektimin (ISO / IEC 17020), çertifikimin e personave (ISO / IEC 17024) dhe çertifikimin e sistemeve të menaxhimit (ISO 17021-1).



8. OVK-të e akredituara nga DPA mund t'i referohen statusit të nënshkruesit të EA MLA të DPA-së vetëm për fushat përkatëse për të cilat DPA është nënshkruese e EA-MLA.
9. Organet certifikuese të akredituara nga DPA mund të përdorin markën ILAC MRA ose markën IAF MLA në kombinim me simbolin e akreditimit (logo e kombinuar) gjatë vlefshmërisë së akreditimit të tyre, vetëm pasi të marrin leje nga DPA.

Politika DA-PO-007

Dokumenti DA-PO-007 përshkruan politikën e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit në lidhje me skemat e testeve të zotësisë dhe krahasimeve ndërlaboratorike dhe pjesëmarrjen e laboratorëve kalibruer, testues, mjekesore, organeve certifikuese të produkteve dhe organeve inspektuese (kur është relevante). Testet e zotësisë mund të përdoren në disa tipe të inspektimit apo certifikimit të produkteve (kur është e vlefshme) në rastet kur rezultatet e aktivitetit të testimit ndikojnë direkt dhe përcaktojnë rezultatin e inspektimit apo certifikimit ose kur kërkohet nga ligji ose rregullatorët.

Ndryshimet kryesore janë:

1. Detyrimet e OVK për pjesëmarrjen në skemat e zotësisë dhe krahasime ndërlaboratorike, duke përfshirë këtu edhe organet inspektuese dhe certifikuese të produkteve.
2. Aplikantët dhe laboratorët testues/kalibruer, trupat inspektues dhe/ose certifikues të produkteve të akredituar apo që janë në vlerësim duhet të demonstrojnë performancën e tyre nëpërmjet pjesëmarrjes në skema zotësie të përshtatshme apo nëpërmjet krahasimeve ndërlaboratorike të organizuar nga organizatorë të besueshëm dhe të arrijnë performancë të suksesshme.
3. Laboratorët që aplikojnë për akreditim fillestar apo zgjerim të akreditimit janë të detyruar të marrin pjesë në teste zotësie/krahasime ndërlaboratorike të përshtatshëm përpara aplikimit për akreditim për matricat apo grup matricat e ngjashme. Testi/kalibrimi ku laboratori ka marrë pjesë duhet të përfshihet në fushën për të cilin është kërkuar akreditimi. Pjesëmarrja e suksesshme është kusht për marrjen e vendimit të akreditimit.
4. Laboratorët e akredituar, gjatë ciklit të akreditimit, duhet të marrin pjesë të paktën një herë në skema të testeve të zotësisë/krahasime ndërlaboratorike të vlefshme dhe të përshtatshme për çdo teknikë prove të akredituar
5. Laboratorët duhet të zhvillojnë planin dhe nivelin e frekuencës në pjesëmarrjen në PT për të gjithë ciklin 4 vjeçar të akreditimit.
6. DPA pranon të gjitha testet e zotësisë/krahasimet ndërlaboratorike të akredituar sipas ISO/IEC 17043:2010 nga organizma akreditues firmosës të marrëveshjeve të njohjes reciproke (MLA) me EA dhe ILAC.
7. DPA vlerëson performancën e laboratorit në teste zotësie/krahasim ndërlaboratorik, nëse këto janë të vlefshme gjatë vizitës për akreditim fillestar, vizitave mbikëqyrëse, vizitave të jashtëzakonshme apo vizitave rivlerësuese.
8. Rezultatet e kënaqshme në pjesëmarrjen në skemat e zotësisë/krahasimet ndërlaboratorike janë një prej kushteve për një vendim pozitiv për akreditim fillestar ose për zgjerimin e akreditimit.



9. DPA mund të pezullojë testin/kalibrimin përkatës nëse performanca e labroatorit është e dyshimtë apo e pakënaqshme.

Politika DA-PO-008

Dokumenti DA-PO-008 përshkruan politikën e Drejtorisë së Përgjithëshme e Akreditimit në lidhje me kërkesat për gjurmueshmërinë e matjeve që kërkohet nga standardet ISO/IEC 17025 dhe ISO 15189. Kjo politikë mund të përdoret gjithashtu edhe për organet e tjera të vlerësimit të konformitetit ku përfshihet testimi dhe/ose kalibrimi si psh inspektimi, organizimi i PT/ILC, prodhimi i materialeve referuese të certifikuara apo certifikimi i produktit. Rrugët për sigurimin e gjurmueshmërisë në matje nuk kanë ndryshuar. Dokumenti është në përputhje me dokumentin ILAC P 10:07/2020.

Ndryshimet kryesore janë:

1. Organi i vlerësimit të konformitetit që kryejnë kalibrime të brendshme në mbështetje të aktiviteteve të tyre të akredituara, kërkohet që të japë me detaje kompetencën e personelin që kryen kalibrimin, metodologjia e përdorur, vendosjen e gjurmueshmërisë dhe buxhetet e pasigurisë të këtyre kalibrimeve tek DPA
2. Përfshirja e kalibrimeve të brendshme në planin e auditimeve të brendshme që vetë OVK kryen. Rastet kur OVK-se i kërkohet përfshirja e kalibrimeve në auditimin e brendshëm janë listuar në politikë.
3. Është rekomanduar që organet e vlerësimit të konformitetit të bazohen në udhëzuesit ILAC G-24 dhe DA-IN-011 në lidhje me intervalin e kalibrimeve.

Të gjithë dokumentat e ndryshuar do t'i gjeni në faqen zyrtare të DPA (www.dpa.gov.al).